



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Prilazheni/Prodato Received/Delivered	25.03.2022	2	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jednica Org./Unit	SKDM/SHCK	1615/2022	115



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.111/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, me Rushit Kajtazi- Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.111/2022 të datës 10.02.2022 të parashtruar nga ankuesi të cilin me autorizim e përfaqëson Avokat nga Prishtina, kundër Vendimit Nr.Ref:07/2022 të datës 11.01.2022 të Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në çështjen juridik "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafi nënparagrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datë 25.03.2022, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr.111/2022 e datës 10.02.2022 e parashtruar nga ankuesi
- II. Mbetet në fuqi Vendimi Nr. Ref: 07/2022 i datës 11.01.2022 i Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, përmes përfaqësuesit me autorizim, më datë 10.02.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 657/2022, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, kundër Vendimit Nr.Ref: 07/2022 të datës 11.01.2022 të Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me pretendimet ankimore se vendimi i kundërshtuar është i pa drejtë, kontradiktor dhe i pabazuar në legjislacionin në fuqi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje referuar Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave

në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 15.02.2022, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës (*tutje referuar MPJD*). Ndërsa me datë 25.02.2022, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritator ka administruar këto prova: Ankesën A.nr.111/2022 të datës 10.02.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; emali i datës 10.02.2022 nga ankuesi për përfaqësuesin me autorizim, emali i datës 12.01.2022 lidhur me pranimin e Vendimit Nr.Ref:07/2022 të datës 11.01.2022; Vendimin Nr.Ref:07/2022 të datës 11.01.2022, Vendimin Nr.Ref:270/2021 të datës 08.12.2021 për pezullim të marrëdhënies së punës së ankuesit; Kërkesën me numër reference 140/2021 të datës 26.11.2021 të ankuesit për pezullim të marrëdhënies së punës; Vendimin me Nr.Ref: 32/2020 të datës 01.09.2020 për sistemimin e përhershëm të ankuesit; Vendimin me Nr.308/2020 të datës 10.07.2020; Vendimin me Nr.Ref:204/2016 të datës 13.05.2016, Autorizimin për përfaqësim për Avokatin

Përgjigjen në ankesë me numër protokollit 989/2022 të datës 25.02.2022; Kontratën e marrëdhënies së punës së ankuesit të datës 15.06.2009; Kontratën e marrëdhënies së punës së ankuesit e datës 14.06.2011; Vendimin me numër MPJ-ZSP 003/2012 të datës 13.01.2012, Akt Emërimit të datës 13.01.2012 për ankuesin; Akt Emërimit të datës 05.09.2012 për ankuesin, Ndryshim dhe Plotësim i Akt Emërimit të datës 08.07.2013 për ankuesin; Akt Emërimit AE.nr.15/2021 të datës 19.02.2021, emalin e datës 11.02.2022 për menaxherin e Personelit të MPJD-së, fq1/2, emalin e datës 25.02.2022 të menaxherit të Personelit të MPJD-së për KPSHC/lidhur me dërgimin e provave shtesë ; dokumentime titull Sistemi i Personelit të Integruar, fq.1/6, Raportin Final i Auditimit me numër protokollit 10/2895 të datës 03.11.2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se janë të pabazuara pretendimet ankimore të ankuesit, *sepse,*

Nga administrimi i provave të lëndës, Kolegji ka gjetur se ankuesi është i punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe se i njëjti nga pozita e *Udhëheqësit të Divizionit për Traktate dhe Marrëveshje Ndërkombëtare* sipas Ndryshim dhe plotësim Akt Emërimit Nr.56/2013 të datës 08.07.2013, me Vendimin Nr.Ref:204/2016 të datës 13.05.2016 të Ministrisë të Punëve të Jashtme ishte caktuar që të shërbejë në gradën *Këshilltar* në Konsullatën e Republikës së Kosovës në Cyrih/Zvicër.

Ankuesi me rastin e përfundimit të mandatit diplomatik më datë 10.07.2020, me Vendimin Nr.132/2020 të datës 01.09.2020 të Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të MPJD-së është sistemuar në mënyrë të përhershme në pozitën *Udhëheqës i Departamentit për Çështje Ligjore dhe Traktate*, konform të cilit vendim i është lëshuar Akt Emërimi AE Nr.15/2021 i datës 19.02.2021 me titull të vendit të punës Drejtor për Çështje Ligjore dhe Traktate.

Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës më datë 11.01.2022 ka nxjerrë Vendimin Nr.Ref:07/2022 të datës 11.01.2022, me të cilin ka shfuqizuar Vendimin me Nr.Ref: 132/2020 të datës 01.09.2020 për sistemimin e përhershëm të ankuesit në pozitën e Drejtorit të Departamentit për Çështje Juridike si dhe Akt Emërimit AE Nr.15/2021 të datës 19.02.2021, duke përcaktuar se ankuesi pas përfundimit të pushimit pa

pagesë të aprovuar sipas Vendimit Nr.Ref: 71/2021 të datës 22.03.2021, sistemohet në pozitën e punës sipas Akt Emërimit Nr.176 të datës 23.05.2016, me arsyetimin se sistemi i nëpunësit civil pas kthimit nga mandati diplomatik nuk është bërë në pajtim me dispozitat e nenit 39 dhe 52 të Ligjit Nr.06/L-116 për Zyrtarët Publikë .

Ankuesi i pakënaqur me Vendimin me Nr. Ref: 07/2022 të datës 11.01.2022 të Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të MPJD-së, brenda afatit ligjor ushtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me pretendimet ankimore se vendimi i kundërshtuar është i pa drejtë, kontradiktor dhe i pabazuar në legjislacionin në fuqi. Shton se bazuar në nenin 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë si dhe nenin 23 paragrafin 2 të Ligjit Nr.03/L-122 për Shërbimin e Jashtëm, çështja e transferimit, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë janë kompetencë e plotë e ministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, fakt ky i theksuar në pikën 3 të Vendimit Nr.308/2020 të datës 10.07.2020. Në mungesë të akteve ligjore lidhur me barasvlerën e gradave diplomatike në raport me pozitat e kategorive të nëpunësve civil brenda MPJD-se, lëvizja e stafit nga shërbimi diplomatik dhe anasjelltas është bërë sipas diskreditonit të ministrit të MPJ-së. Kërkon që Këshilli ta aprovoj ankesën, ta anuloj Vendimin Nr.Ref.07/2022 të datës 11.01.2022 të Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, si dhe të obligoj të njëjtin që ankuesin ta kthej statusin e fituar sipas Vendimit Nr.Ref:132/2020 të datës 01.09.2020 dhe Akt Emërimit AE.Nr.15/2021.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore Kolegji ju referuar nenit 4 të Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë me të cilin është përcaktuar se: *Nëpunësit profesionalë të shërbimit diplomatik dhe shërbimi korrektues janë nëpunës civilë me status të veçantë, të cilët rregullohen me këtë ligj dhe me ligj të veçantë”, ndërsa paragrafi 2 i këtij neni ka përcaktuar që: “Rregullimi me ligj të veçantë, sipas paragrafit 1 të këtij neni, duhet të jetë në pajtim me parimet e përcaktuara me këtë ligj dhe mund t’i rregullojë ndryshe vetëm këto elemente të marrëdhënies së punës: 2.1. kushte të veçanta apo shtesë për rekrutim; 2.2. të drejtat ose detyrimet specifike të tjera nga ato të parashikuara me këtë ligj; 2.3. rregullat e veçanta për zhvillimin e karrierës sipas sistemit të gradave; 2.4. zhvillimin profesional dhe nevojat për trajnime; 2.5. transferimin dhe sistematizimin e nëpunësve” dhe rrjedhimisht Kolegji ka konstatuar se në mungesë të akteve të veçanta të Ministrisë së Punëve të Jashtme PJD-së lidhur me sistemin dhe ri caktimin e nëpunësve civil pas përfundimit të mandatit diplomatik, trajtimi i pretendimeve ankimore bazohet në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, bazuar në provat materiale të ofruara nga palët në procedurë, ka konstatuar së ankuesi me rastin e caktimit që të shërbej në mision diplomatik ka qenë i emëruar dhe ka ushtruar pozitën *Udhëheqës i Divizionit për Traktate dhe Marrëveshje Ndërkombëtare* sipas Ndryshim dhe plotësim Akt Emërimit Nr.56/2013 të datës 08.07.2013, ndërsa pas kthimit nga misioni diplomatik, i njëjti me Vendim të Sekretarit të Përgjithshme Nr.132/2020 të datës 01.09.2020 është sistemuar në mënyrë të përhershme në pozitën *Drejtori i Departamentit për Çështje Ligjore dhe Traktate* duke ju lëshuar edhe Akt Emërimi AE.Nr.15/2021 i datës 19.02.2021. Nisur nga ky fakt Kolegji vlerëson se ricaktimi i ankuesit nga pozita e Udhëheqëset të Divizionit si pozitë e nivelit të ulet drejtues në pozitën e Drejtorit të Departamentit si pozita e mesme drejtuese, pa zhvillim të procedurës se ngritjes në detyrë është në kundërshtim të plotë me dispozitat e nenit 39 paragrafi 3 Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë me të cilin theksohet se: *Ngritja në detyrë realizohet nëpërmjet një procedure konkurruese të organizuar nga Njësia e Burimeve Njerëzore të institucionit, që ka pozitën e lirë” dhe nenin 4 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin*



Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: *Nëpunësit civil pranohen dhe avancohen në karrierë në bazë të meritës të vlerësuar në bazë të një procedure konkurruese dhe transparente, të përcaktuar në bazë të Ligjit dhe akteve përkatëse nënligjore*". Andaj mbi këto arsye Kolegji konstaton se çdo avancim respektivisht ngritje në detyrë që është në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji nuk është i lejueshëm gjegjësisht si i tillë është i paligjshëm.

Duke marrë parasysh se transferimi i përhershëm i ankuesit sipas Vendimin me Nr.Ref: 132/2020 të datës 01.09.2020 bazohej në nevojat institucionale, Kolegji ju referua dispozitave të nenit 52 paragrafi 1 nen paragrafi 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë me të cilin është përcaktuar se: *Nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në një pozitë tjetër të Shërbimit Civil të së njëjtës kategori, në këto raste: 1.1. kur është në interes të institucionit, deri në 6 muaj gjatë 2 vjetëve;.....* Andaj në kuptim të këtyre dispozitave ligjore Kolegji konstaton se transferimi për nevoja institucionale mund të behët vetëm për një periudhë 6 mujore brenda dy vite dhe brenda së njëjtës kategori funksionale, kërkesa të cilat sipas vlerësimit të Kolegjit nuk janë përmbushur me rastin e transferimit të përhershëm të ankuesit sepse transferimi është bërë në mënyrë të përhershme dhe nuk është bërë brenda kategorisë së njëjtë funksionale, kështu që nisur nga ky konstatim si dhe duke marrë parasysh rrethanat si me lartë rezultojnë se janë të pabazuara pretendimet ankimore të ankuesit se Vendimi Nr.Ref:07/2022 të datës 11.01.2022 i është i pa drejt dhe i nxjerrë me shkelje ligjore.

Në vështrim të dispozitave të nenin 52 paragrafi 1.3 dhe 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, një vendim i nxjerrë me shkelje të dispozitave procedurale dhe në kundërshtim me ligjin material është akt i paligjshëm, kështu që pas konstatimit se sistemimi i ankuesit nga pozita e *Udhëheqës i Divizionit për Traktate dhe Marrëveshje Ndërkombëtare* në pozitën *Drejtori i Departamentit për Çështje Ligjore dhe Traktate* është bërë pa respektim të procedurës ligjore, rrjedhë se organi i punësimit me rastin e nxjerrjes së Vendimit Nr. Ref: 07/2022 i datës 11.01.2022 ka zbatuar drejtë ligjin material duke vepruar në pajtim me nenin 53 paragrafi 1 dhe nenin 55 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Andaj, duke përmbledhur sa më sipër, Kolegji për Vendosjen dhe Shqyrtimin e Ankesave pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës, si dhe duke u bazuar në nenin 132 paragrafi 2 si dhe nenin 18 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.


Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike:

Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicim konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.111/2022

Rushit Kajtazi


Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj-Demiⁿ



Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit me autorizim Avokatit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së